



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

28-07-2023

01-110/05-988

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d,të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2018, për Transparencën në Komuna, neni 7 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, dhe neni 36 paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën: 27.07.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen në diskutim publik draft propozim rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2024

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miratim vendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik propozim rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2024.

Neni 2

Propozimi në diskutim publik i propozim rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2024 do të jepet në diskutim publik deri me: 02.09.2023. Propozimet, sugjerimet për plotësim ndryshim apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes së debatit publik, gjithashtu në formën të shkruar munde të paraqiten gjate kohëzgjatjes së dëgjimit publik ne zyrën e drejtorisë së financave së Komunës të Vitisë ndërtesa e komunës zyra nr. 31 si dhe në forme elektronike munde të dërgohen ne emalin adresën shefki.aliu@rks-gov.net, dokumenti gjendet në wep faqen e komunës së Vitisë, kk.rks-gov.net/viti.

Neni 3

Debati publik do të mbahet me datën: 04.09.2023 në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive në Propozim rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2023.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi ditën e publikimit në web faqen e komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit,
2. MAPL-së, dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi